



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2022:096429
Datë: 02.10.2024
Numri i dokumentit: 06245288

K.DH.SH.II.nr.479/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit KS Siguria, me seli në Prishtinë, ndaj debitorit Trepça me seli në Mitrovicë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1672/22 të datës 29.12.2023, me datën 02.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit “Siguria” Sh.A., me numër unik identifikues 70167671 dhe seli në Prishtinë, rr. “Luan Haradinaj, ndërsa aktvendimit i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Ekonomik, KPPP.nr.1672/22 të datës 29.12.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Ekonomik, me aktvendimin e ankimuar, ka vendosur Ndërpritet procedura në çështjen përmbarimore në mes të kreditorit Kompania e Sigurimeve “Siguria” Sh.A., kundër debitorit “Trepça” - Ndërmarrje nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), e lejuar sipas Urdhrit Përmbarimor

P.nr. 721/2015 të datës 03.12.2015, të Përmbauesit Privat Flamur S. Bogaj, për shkak të likuidimit të detyrueshëm ndaj debitorit.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj këtë ankesë si të bazuar, aktvendimin e ankimuar të anuloj dhe lëndën të kthej në rishqyrtim dhe rivendosje.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përbarimore (LPP), gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh rezulton që si debitor në propozimin për përbarim është evidentuar subjekti “Trepça Ndërmarrje nën Administrimin e AKP” me numër unik identifikues 811278747, e cila sipas të dhënave nga regjistri i ARBK-së është ndërmarrje shoqërore nën administrimin e AKP-së, dhe jo “Trepça” Sh.A me numër unik identifikues 811278747, meqenëse kjo e fundit është themeluar me ligjin përkatës në vitin 2019, pra pas paraqitjes së propozimit. Në anën tjetër, propozimit për përbarim i është bashkangjitur fatura nr. 704/11 e datës 06.09.2011, që nënkupton se raporti juridik në mes të kreditorit KS Siguria dhe debitorit Trepça – Ndërmarrje nën administrimin e AKP-së është krijuar para hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 05-L-120 për Trepçën.

Kundër urdhrin përbarimor debitori ka paraqitur prapësim, me të cilin ka kundërshtuar Urdhrin për përbarim. Kreditori me përgjigje në prapësim e ka kundërshtuar prapësimin dhe ka kërkuar nga gjykata që të refuzoj prapësimin e debitorit.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Ekonomik, me aktvendimin e ankimuar, e ka vendosur të Ndërpritet procedura në çështjen përbarimore në mes të kreditorit Kompania e Sigurimeve “Siguria” Sh.A., kundër debitorit “Trepça” - Ndërmarrje nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), e lejuar sipas Urdhrin

Përmbartimor P.nr. 721/15 të datës 03.12.2015, të Përmbartuesit Privat Flamur S. Bogaj, për shkak të likuidimit të detyrueshëm ndaj debitorit. Në lidhje me këtë, me nenin 14 të ligjit nr. 05-L-120 për Trepçën, paragrafi 1 dhe 2 i saj përcaktohet se *“Pretendimet kreditore ndaj Ndërmarrjes Shoqërore Trepça të dorëzuara në Agjencinë Kosovare të Privatizimit sipas ligjit Nr. 04/L-035 për riorganizimin e Ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin përkatës, trajtohen sipas ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. 2. Pretendimet tjera të mundshme kreditore ndaj Ndërmarrjes Shoqërore Trepça të paraqitura deri në datën e vendosjes në likuidim të aseteve sipas nenit 14 të këtij ligji, trajtohen sipas ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit”*.

Në këtë drejtim, meqenëse kemi të bëjmë me propozim për përmbartim për realizimin e një kërkesë ndaj debitorit “Trepça Ndërmarrje nën Administrimin e AKP”, Gjykata iu referua neni 10, paragrafi 1 i saj të shtojcës së ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit i cili përcakton se *“Çdo veprim gjyqësor, administrativ apo i arbitrazhit, procedurë apo akt që përfshin apo që është kundër një ndërmarrje (apo aseteve të saj) që është subjekt i Vendimit për Likuidim pezullohet pas parashtrimit të njoftimit të Vendimit për Likuidim nga ana e Autoritetit të Likuidimit në gjykatën përkatëse, autoritetin publik apo tribunalin e arbitrazhit. Ky njoftim i referohet këtij neni 10 dhe shoqërohet me një kopje të Vendimit për Likuidim dhe një kopje të Njoftimit të publikuar për likuidim”*. Ndërsa, me nenin 277.1, pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) i cili gjen zbatim përshtatshmërisht në këtë çështje përmbartimore përcaktohet se *“Procesi gjyqësor ndërpritet: d) kur paraqitet propozimi për fillimin e procedurës së falimentimit në kontestet në të cilat i padituri është debitor falimentues”*.

Referuar dispozitave të lartcekura, meqenëse debitor në këtë çështje përmbartimore paraqitet “Trepça Ndërmarrje nën Administrimin e AKP”, e në anën tjetër, kërkesa që buron nga dokumenti i besueshëm nuk ka kaluar si detyrim tek Trepça Sh.A, pasi që është bërë e arritshme para hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 05-L-120 për Trepçën, atëherë rezulton se procedura në këtë çështje përmbartimore në kuptim të nenit 277, pika (d) duhet të ndërpritet, kjo për faktin se duke qenë në procedurë të likuidimit, debitori ka cilësinë e debitorit falimentues .

Në rastin konkret Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së

shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe as ne konstatim te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur ka vendosur te Ndërpritet procedura në çështjen përmbartimore në mes të kreditorit Kompania e Sigurimeve “Siguria” Sh.A., kundër debitorit “Trepça” - Ndërmarrje nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), e lejuar sipas Urdhrit Përmbartimor P.nr. 721/15 të datës 03.12.2015, të Përmbartuesit Privat Flamur S. Bogaj, për shkak të likuidimit të detyrueshëm ndaj debitorit. Neni 14 të ligjit nr. 05-L-120 për Trepçën, paragrafi 1 dhe 2 i saj përcaktohet se *“Pretendimet kreditore ndaj Ndërmarrjes Shoqërore Trepça të dorëzuara në Agjencinë Kosovare të Privatizimit sipas ligjit Nr. 04/L-035 për riorganizimin e Ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin përkatës, trajtohen sipas ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. 2. Pretendimet tjera të mundshme kreditore ndaj Ndërmarrjes Shoqërore Trepça të paraqitura deri në datën e vendosjes në likuidim të aseteve sipas nenit 14 të këtij ligji, trajtohen sipas ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit”*.

Dhoma e Shkallës së Dytë e pranon qëndrimin juridik te gjykatës se shkallës së parë e cila është bazuar në nenin 10, paragrafi 1 i saj të shtojcës së ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit i cili përcakton se *“Çdo veprim gjyqësor, administrativ apo i arbitrazhit, procedurë apo akt që përfshin apo që është kundër një ndërmarrje (apo aseteve të saj) që është subjekt i Vendimit për Likuidim pezullohet pas parashtrimit të njoftimit të Vendimit për Likuidim nga ana e Autoritetit të Likuidimit në gjykatën përkatëse, autoritetin publik apo tribunalin e arbitrazhit. Ky njoftim i referohet këtij neni 10 dhe shoqërohet me një kopje të Vendimit për Likuidim dhe një kopje të Njoftimit të publikuar për likuidim”*. Ndërsa, me nenin 277.1, pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) i cili gjen zbatim përshtatshëmrisht në këtë çështje përmbartimore përcaktohet se *“Procesi gjyqësor ndërpritet: d) kur paraqitet propozimi për fillimin e procedurës së falimentimit në kontestet në të cilat i padituri është debitor falimentues”*. Referuar dispozitave të lartcekura, meqenëse debitor në këtë çështje përmbartimore

paraqitet “Trepça Ndërmarrje nën Administrimin e AKP”, e në anën tjetër, kërkesa që buron nga dokumenti i besueshëm nuk ka kaluar si detyrim tek Trepça Sh.A, pasi që është bërë e arritshme para hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 05-L-120 për Trepçën, atëherë rezulton se procedura në këtë çështje përmbarimore në kuptim të nenit 277, pika (d) duhet të ndërpritet, kjo për faktin se duke qenë në procedurë të likuidimit, debitori ka cilësinë e debitorit falimentues.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë i vlerësoi edhe pretendimet ankimore të kreditorit por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.479/24, me datë 02.10.2024

Gjyqtarja
Franciska Zhitija Ymeri